

QENDRA E STUDIMEVE ALBANOLOGJIKE
INSTITUTI I ARKEOLOGJISË
TIRANË

ILIRIA

REVISTË ARKEOLOGJIKE

Me rastin e 65 vjetorit të Arkeologjisë Shqiptare

Nr. XXXVII

2013

TIRANË 2015

njëpasnjëshme, nga të cilat mbeten disa struktura muresh në anen veri - perëndimore, që duhet të identifikohen dhe të hetohet më thellë në fushatat e ardhshme të gërmimeve.

- Mungesa absolute e objekteve të ndërtuara dhe madje edhe materialeve gjatë periudhës Perandorake Romake.

- Ndërtimi i Bazilikës së krishterë (fundi i shek V – fillimi i shek VI) dhe transformimin e saj të mëvonshëm gjatë Mesjetës së hershme në kishëz e vogël, e cila ndërtohet mbi nefin qendror të shembur të bazilikës.

Restaurimet konservuese

Përveç gërmimeve dhe studimeve të përshkruara më sipër, gjatë të njëjtës fushatës janë kryer dhe ndërhyrje për të mbrojtur strukturat, afresket, dyshemetë dhe sipërfaqet me mozaik të zbuluara gjatë këtyre gërmimeve, por edhe gjatë gërmimeve të viteve të mëparshme. Ky është një rregull që ne kemi ndjekur gjithmonë, me besimin se është një detyrim i yni për të mbrojtur, për të vlerësuar dhe për të ndaluar progresin e mundshëm të degradimit të strukturave të gjetura dhe të lëna *in situ*. Çdo ndërhyrje është kryer duke marrë në konsideratë karakteristikat e brendshme të elementeve mbi të cilët ndërhyet, me qëllim për ti mbrojtur (llaçin antik, strukturat e ndërtuara me mur të thatë pa llaç, tullat, dyshemetë me *cocciopestio*, sipërfaqet me kalldrëm, afresket etj), dhe janë përdorur materiale me karakteristika të përshtatshme që lidhen me natyrën e kontekstit arkeologjik. Përveç kësaj u konsiderua e përshtatshme kryerja e akteve të mirëmbajtjes rutinë për strukturat e përkohshme mbrojtëse (si mbulimet me çati, ulluqet dhe kanalet për largimin e ujrave) për ndërtesat e qytetit që ishin vendosur në vitet e mëparshme nga Misioni Shqiptaro - Italian. Këto ndërhyrje janë bërë kryesisht në zonat e tarracave, si tek Shtëpia me dy peristile, ndërtimin e periudhës perandorake romake pranë saj (zonat e ashtuquajtura më lart C10 dhe C11) dhe në zonën e agorasë helenistike dhe të tempullit *in antis* (A23). Së pari, ndërhyrjet përfshinë rivendosjen e strukturave mbrojtëse dhe mbuluese të përkohëshme, të cilat gjatë stinëve të dimrit ishin vjedhur nga persona të panjohur, duke shkaktuar në shumë raste dëmtime serioze strukturore dhe dëme të shumta në muftet që ato mbulonin. Strukturat mbrojtëse janë ndërtuar me të njëjtat elemente ndërtimi (fletë metalike prej alumini), ndërsa elementët mbajtës të këtyre strukturave që fillimisht ishin metalike janë zëvendësuar nga elementë prej druri. Në një fazë të parë është ndërhyrë nga një pikpamje e thjeshtë mbrojtëse duke veshur strukturat me fletë polietileni të stabilizuar të integruar me fletë PVC (plasmasi), në mënyrë që të sigurohet një funksion të dyfishtë mbrojtës dhe që lejon qarkullimin e ajrit. Së dyti, në ato struktura që kanë nevojë për mbrojtje dhe për të mënjeluar rënimin e strukturës, është bërë një veshje e dytë me një këmishë dërrase, me qëllim ruajtjen e tyre dhe për të lehtësuar ndërhyrjet e ardhshme.

Dhimitër CONDI, David HERNANDEZ

FORUMI ROMAK BUTRINT 2012

Kuadratet e gërmimit u vendosën në Zonat 19, 20, dhe 21 (Fig. 1). Vendndodhjet dhe përmasat e kuadratëve u përcaktuan nga qëllimet e hulumtimit, burimet e projektit dhe topografia e vendit. Qëllimet kryesore ishin: 1.) të gërmohej si brenda (Zona 21) dhe jashtë (Area 20) Ndërtesës Lindore; 2.) të përcaktoheshin kufijtë veriorë (Zona 20) dhe jugorë (Zona 19) të Ndërtesës Lindore; 3.) të shqyrtohej fundi lindor i forumit (Zona 19 dhe 20); 4.) të shqyrtoheshin shkallaret veriore (zona 20) dhe ato jugore (zona 19) të forumit dhe portikët përkatës; 5.) të shqyrtohej hyrja juglindore në forum; 6.) të hetohej për rrugë të mundshme në jug të Ndërtesës Lindore (Zona 19); 7.) të hetohej për lidhjen mes strukturës së harkuar dhe Ndërtesës Lindore (Zona 20); 8.) të gërmohej brenda ndërtesës Lindore (Zona 21); dhe 9.) të gërmohej (potencialisht) nën dyshemenë e Ndërtesës Lindore deri në thellësi të depozitave natyrore (para themelimit të qytetit).

Zona 19

Kuadrati në Zonën 19 kishte përmasa 8,4 m V-J x 12,4 m L-P. Planimetria e post-gërmimit të kuadratit tregon një numër monumentesh të rëndësishme dhe struktura fizike (Fig. 2). Në këtë kuadrat u zbulua këndi juglindor i forumit romak. Dymbëdhjetë pllaka të fragmentuara gëlqerore dolën në dritë. Këto ishin të mirë punuara dhe të lëmuara. Dimensionet e pllakave varionin nga 1,49 x 1,27 m (maksimale) në 0,82 x 0,44 m (minimale). Një pllakë pranë seksionit jugor të kanalit ruante një gjurmë drejtkëndëshe prej ndryshku, shkaktuar nga një monument i cili ishte vendosur fillimisht atje. Kjo ndoshta mund të përfaqësojë gjurmë të një mbishkrimi prej bronzi apo statuje. Gurët gëlqerorë që konturojnë dyshemenë kanë një ulluk. Në shkallët jugore të forumit u zbuluan dy kolona të ruajtura *in situ*. Kolonat (me diametër 45cm) përbëhen nga gurë ranorë dhe të gdhendur (6-7 cm të gjera). Ato ruhen në lartësi prej 1,38 m, tregojnë kurbë dhe i përkasin tipit Dorik. Pjesa e sipërme e kolonave është e sheshtë dhe e punuar për vendosjen e një rreshti të dytë të pjesëve të kolonës. Një nga kolonat, në pjesën e sipërme ka gjurmë të lehta të një vrime qëndrore. Pjesët e kolonës duket se janë bashkangjitur me plumb.




Fig 1 Plan i qendrës urbane dhe zonat e gërmimit 2012




Fig 2 Planimetri e post-gërmimit të kuadrantit 19

me përfundimin e portikut të forumit. Për më tepër, ana jugore e blloqeve të stilobatis është në linjë dhe e mirë-punuar, ndërsa blloqet ngjitur i kanë faqet e brëndshme të parregullta në formë (shih fig. 1). Të dalat e gurëve në formën e deltas janë përdorur si dekor për ndërtesën origjinale, duke formuar një motiv alternativ midis dy shkallëve të stilobatis. Duket se kolona i përkiste ndërtesës origjinale. Kolona është 1,8 m. Të gjitha këto karakteristika të ndërtesës helenistike janë identike me stilobatin e zbuluar në vitin 2007 në fundin jugperëndimor të forumit, që gjithashtu ishte modifikuar dhe inkorporuar në projektimin e forumit (Fig. 2 dhe 3). Të dy fundet duket se përfaqësojnë të njëjtën ndërtesë, domethënë, Stoaan Jugore.

Shkallët mbi të cilat kolonat janë të vendosura fillimisht i përkisnin një ndërtesë helenistike, e cila ishte cinguar në mënyrë të qartë në fundin e saj lindor dhe kur kompleksi u ndërtua, u inkorporua në forum si një portik. Gërmimet në pjesën e pasme të shkallëve zbuluan gurët e themelimit, duke konfirmuar se shkallët fillimisht funksiononin si stilobat i një ndërtesë para-ekzistuese. Stilobati tregon një nivel shumë më të lartë të konsumimit sesa dy shkallët ngjitur në lindje, të cilat përkojnë

Stoa e Jugut duket të ketë qenë më e madhe se 72 m në gjatësi, duke shfaqur të paktën 40 kolona në anën veriore të saj (Fig. 4). Gjerësia e ndërtesës mbetet e panjohur. Kupa të Megaras u zbuluan në depozitat që lidhen me ndërtimin e ndërtesës. Këto e datojnë ndërtesën të shekullit të 2-të para erës sonë. Shëtitortja përfaqëson ndërtesën më të madhe para-romake të njohur në Butrint. Ajo shërben si dëshmi për vendndodhjen e agoras, e cila ka të ngjarë të jetë zëvendësuar nga forumi.



Fig 3. Këndi jugperëndimor i forumit, me stilobatin e Stoa, 2007 (zona 15)

Fasada e Ndërtesës Lindore përballë me forumin është ndërtuar direkt në shkallën e dytë të forumit (Fig. 5). Pjesa e ruajtur përbëhet tërësisht nga radhët me tulla të kuqe, 3-4 cm të trasha, në opus testaceum. Ajo është e ruajtur në një lartësi maksimale prej 0,90 m, që përfaqëson 13 radhët me tulla. Duke gjykuar nga pjesët ekzistuese të të njëjtit mur në Zonën 20, ka të ngjarë që më lart këto radhë do të kenë qenë prej guri dhe tulla në teknikën opus mixtum. Një pilaster prej guri gëlqeror ishte vendosur në cep të ndërtesës. Së bashku





Fig 4. Rindërtim hipotetik i Stoaan Jugore

me kolonën Dorike ngjitur, ajo ka shërbyer për të formuar hyrjen juglindore të forumit. Ana jugore e Ndërtesës Lindore u ndërtua fillimisht me një derë të madhe jashtë aksit, e cila ishte 3 m e gjerë (Fig. 10). Dera u reduktua saktësisht në gjysëm (1,5 m) në një kohë më të vonë, duke shtuar dy muratura përfundimtare në opus testaceum në të dyja anët e derës. Kjo hyrje në fund u bllokua, me sa duket kur ndërtesa u braktis në Antikitetin e Vonë, me vendosjen e dy kolonave të mëdha të granitit, të cilat u zbuluan midis dy mureve mbyllës. Këto kolona duket se përfaqësojnë dy fragmente të së njëjtës kolonë të vetme prej graniti, fillimisht monolite, me një diametër konik. Një tjetër kolonë u gjet në bazën e këtyre dy kolonave bllokuese, ndoshta e vendosur atje në kohën kur dyert ishin bllokuar. Megjithatë, kjo kolonë ishte e vijëzuar me kanelura, e stilit Dorik dhe përbëhej nga gur ranor. Ajo i përkiste Stoas Jugore. Brenda në ndërtesën Lindore, një dysheme e trashë llaçi të verdhë u gjet in situ. Kjo dukej të përfaqësoje ndoshta bazamentin e një dyshemeje prej mermeri apo guri të grabitur. Fasada lindore e Ndërtesës Lindore kishte të ruajtura copëza të degraduara të suvasë, e cila me sa duket ishte fillimisht e pikturuar. Dy tuba uji që përshkonin kanalën u zbuluan me një drejtim lindje-perëndim. Tubi më i hershëm është prej terrakote të lidhur me llaç. Tubi i trashë dhe shtresa e



Fig. 5. Fotografia e pas-gërmimit të zonës 19

North-Facing Elevation of East Building (Area 19)



Roman Forum Excavations at Butrint
Drawing #457
x = 7.28 RL

0 1 m
© David R. Hernandez

Fig. 6. Rilevim i fasadës Veriore të Ndërtesës Lindore


llaçit sugjerojnë se tubi ishte ndërtuar për t'i bërë ballë një presioni të konsiderueshëm. Tubi i terrakotës ishte i dëmtuar dhe mungonte në pjesën lindore. Së bashku me anën e këtij tubi u zbulua in-situ dhe i plotë një tub i dytë. Ky tub është prej plumbi në 5 segmente të ngjitur së bashku. Tubi u gjet në kushte të shkëlqyera dhe nuk ishte i plasaritur, shpërthyer ose thyer. Duke pasur parasysh gjendjen e tij të shkëlqyer, ka mundësi që të ketë mbetje antike të ujit në brendësi të tubit të mbetur nga koha kur ky doli nga përdorimi. Të dy tubat janë elementë të sistemit të akuaduktit, që shërbenin për të transportuar ujë në forum. Në këtë supozim, tubi prej terrakote mund të datojë në periudhën e Augustit, kur u ndërtua forumi dhe akuadukti. Tubi prej plumbi përfaqëson zgjerimin dhe rimodelimin e ujësjellësit në fillimin e shek të 2-të pas Kr. Ndryshe nga tubi prej terrakote, tubi prej plumbi drejtohej në një kënd të forumit, duke sugjeruar se ai kalonte në portikun jugor të forumit, ndoshta për të furnizuar me ujë një shatërvan apo burim tjetër në forum.



Fig. 7. Varre në Ndërtesën Lindore, shek 6të pas Kr,
Zona 19

Mbetjet e një ndërtese të madhe Helenistike / Romake të

Post-Excavation Plan of Area 20



Roman Forum Excavations at Butrint
Drawing #482

0 5 m
© David R. Hernandez

Fig. 8. Planimetri e post-gërmimit Zona 20



Fig. 9. *Dyshemeja e forumit me shkallët veriore, Ndërtesa Lindore dhe një bazament statuje*




Fig. 10. *Rilevim i fasadës perëndimore të Ndërtesës Lindore në Zonën 20*




Fig. 11. *Rilevim i fasadës së Antikitit të Vonë të Ndërtesës Lindore, Zona 20*

hershme të ndërtuar me mur guri u zbulua në jug të Ndërtesës Lindore. Datimi i strukturës sugjeron se ajo u ndërtua pas tubit prej terrakote dhe në të vërtetë ishte shkaku për ndërprerjen e tubit. Prerjet në një prej blloqeve tregojnë se ai ka funksionuar si një prag për një derë, e cila mund të ketë qënë e hapur në rrugën, në juglindje të hyrjes për në forum. Ndërtesa u shkatërrua më vonë për futjen e tubit prej plumbi, e cila në mënyrë të qartë ka ndërprerë ndërtesën, duke përfshirë edhe pjesë të gurit të pragut. Kështu që kjo ndërtesë mund të datohet në intervalin ndërmjet dy tubacioneve, me shumë mundësi në shekullin 1-rë pas Kr.

Qeramika që daton deri në shekullin e 5-të pas Kr, u gjet në depozitat mbi dyshemenë prej llaçi të ndërtesës së Lindjes. Relativisht shpejt pas braktisjes së ndërtesës, depozita të dendura mbetjesh mbushën ambientet e brendshme. Deri në fund të shekullit të 6 pas Krishtit, më shumë se një metër mbushje ishte formuar brenda ndërtesës. Një seri varresh ishin vendosur në ndërtesë, e cila u përdor si një mauzoleum në fund të shekullit të shek. 6-të pas Krishtit (Fig. 7). Kjo datë shërben si një terminus ante quem për grabitjen dhe braktisjen e Ndërtesës Lindore.

Zona 20

Kuadrati në zonën 20 kishte përmasa 13 m Veri-Jug me 3.5 m Lindje – Perëndim (Fig. 8-10).

Gërmimet zbuluan murin perëndimor të Ndërtesës Lindore me pamje nga dyshemeja e forumit.

Muri në opus mixtum ishte ruajtur në një lartësi (maksimale) prej 2,7 m. Kjo është e njëjta ndërtesë me atë të zbuluar në Zonën 19. Muri përshkon kuadratin drejt veriut në një distancë rreth 10 m dhe përfundon në një gur në qoshe, i cili ishte pjesë origjinale e ndërtesës.

Në një fazë të veçantë të ndërtimit, një mur opus-incertum është ndërtuar ngjitur me gurin e qoshes dhe vazhdonte drejt veriut për të formuar këndin veriperëndimor të ndërtesës. Është e mundshme, siç shpjegohet edhe më poshtë, se muri në opus-mixtum përfaqëson fazën e parë të ndërtesës dhe muri në opus-incertum një fazë të dytë.

Ndërtesa Lindore kishte një derë të madhe qendrore, 3,4 m të gjerë, e cila ishte bllokuar në një fazë të mëvonshme. Bllokimi i derës tregon se ndërtesa pushoi së komunikuar me forumin në fazën e saj të fundit. Reduktimi i hyrjes jugore të ndërtesës nga gjysma (1,5 m), zbuluar në Zonën 19, ndoshta i përket kësaj faze të fundit të ndërtesës. Fillimisht, Ndërtesa Lindore ishte e orientuar drejt Perëndimit përballë me forumin, siç dëshmohet nga dera e madhe qendrore. Në fazën përfundimtare, megjithatë, ndërtesa duket se është orientuar drejt Jugut, me anën Perëndimore të ndërtesës që nuk ka komunikim me forumin.

Muri Verior i ndërtesës ishte cunguar në një fazë të mëvonshme pranë qoshes veriperëndimore të ndërtesës, e cila me sa duket përfaqëson fazën e ndërtimit në opus incertum. Qëllimi i shkurtimit ishte për të ndërtuar një aneks që do të zgjerohet në fundin verior të ndërtesës. Aneksi, i cili ka strukturë me kube në opus testaceum e vëzhguar nga Ugolini, ndërpritej me këndin e prerë të murit verior të ndërtesës. Ai vazhdon në një distancë prej 6,5 m në veri, para se të përfundojë në një gur në qoshe të latuar. Dy muret e mbijetuar të aneksit tregojnë se kubeja mbulonte një hapësirë prej 8,6 m në gjerësi. Vrimat e mëdha drejtkëndëshe të vendosura rregullisht në mure, në nivelin e fillimit të kubesë, shërbenin për të mbështetur trarët e drurit për një kat të dytë. Çuditërisht, fundi verior i aneksit ishte pa mure dhe skajet veriore përfundonin pa një kthim. Është e mundur që aneksi është ndërtuar kur orientimi i Ndërtesës u bë Veri-Jug, pasi dera për në forum u bllokua.

Distanca Veri – Jug e Ndërtesës Lindore matur nga cepi i saj veriperëndimor në



Fig. 12. *Shtëpi e Antikitit të Vonë/Mesjetare me pus dhe mur taracues*

Zonën 20 deri në cepin e saj jugperëndimor në Zonën 19 është 23,3 m. Shtimi i aneksit ka rritur madhësinë e ndërtesës në 30 m.

Gjerësia e dyshemesë së forumit në fundin lindor të forumit, i matur nga bazat e shkallëve veriore dhe jugore, është 19 m. Në fundin perëndimor, forumi ka një gjerësi prej 20 m. Dallimi i 1 m mund të llogaritet disi nga fakti se ana perëndimore e forumit është në një kënd të vogël dhe jo pingul me portikun paralel të forumit.

Pllakat gëlqerore të dyshemesë u gjetën in situ, me drejtim përgjatë fundit Lindor të forumit. Gjashtë nga pllakat e dyshemesë në pjesën veriore të forumit, ku kufizoheshin me ullukun prej guri gëlqeror, ishin të plasaritura në gjysmën pranë aksit të tyre qëndror Veri-Jug. Pllaka e shtatë në këtë seri është zhdukur sepse ajo ishte grabitur në periudhën e hershme mesjetare kur një gropë e thellë u gërmua nga lart. Pjesë e një bazamenti prej mermeri të bardhë dhe me derdhje ishte vendosur në shkallën e parë të forumit, ngjitur me anën veriore të derës qendrore të ndërtesës Lindore. Bazamenti do të kishte shërbyer për mbështetjen e një statujë ose mbishkrimi. Pjesa perëndimore e bazamentit ishte grabitur së bashku me pllakën e dyshemesë. Hapësira e krijuar nga pllaka që mungonte zbuloi se forumi është ndërtuar me një kanal kullimi nëntokësor me drejtimin përgjatë anës Lindore të forumit nën pjesën Lindore. Duket se pllakat janë plasaritur kur ato u goditën nga një peshë para se kanalet kulluese të mbusheshin pas braktisjes së forumit. Duke pasur parasysh afërsinë e ndërtesës, është e mundur që një pjesë e madhe muresh u rrëzuan nga Ndërtesa Veriore, duke plasaritur në gjysmë pllakat e gurit gëlqeror rreth 22 cm të trasha. Tërmeti i fundit të shekullit të 4 pas Kr mund të ketë qenë shkaku i kësaj shembjeje. Tërmeti i fundit të shekullit të 4 pas Kr, mund të ketë qenë edhe shkaku që solli fundin e forumit.

Pesë shkallë prej guri gëlqeror u gjendën in situ, duke formuar anën veriore të forumit. Këto pesë shkallë lidhen me pesë shkallët e gjetura në 2006 në zonën 6 përballë ndërtesës dykatëshe. Tashmë është e qartë se forumi në fazën përfundimtare ka pasur 5 shkallë në anën Veriore. Dy shkallët e poshtme i përkisnin një faze më të hershme, me shumë gjasa kohës së ndërtimit të dyshemesë. Këto shkallë paraqiten më të konsumuara dhe janë ndërtuar me një gur gëlqeror të ndryshëm. Një kolonë prej tullash, e cila është ngjitur me murin opus incertum të ndërtesës Lindore dhe gjurmët e llaçit të një tjetër kolone sugjerojnë se një kolonadë ka përshkruar shkallën e pestë.

Kjo situatë tregon se tre shkallët e sipërme dhe muri opus incertum janë të njëkohshëm dhe përbëjnë një fazë të dytë zhvillimi pas ndërtimit të forumit. Gërmimet pas shkallëve zbuluan një tubacion prej terrakote i cili ka transportuar ujë nga Ndërtesa Lindore. Poshtë tubit gërmimet identifikuan një rrugë prej kalldrëmi që duket të jetë e së njëjtës periudhë me portikun prej dy shkallësh në anën Veriore të forumit.

Pjesa e pasme e një ndërtese të madhe e periudhës së Antikitetit të Vonë u zbulua përgjatë anës perëndimore të Zonës 20. (Fig. 15). Muratura e ndërtesës tregon të paktën tre

faza ndërtimi. Faza e parë duket të jetë ndërtuar në shek. e 6-të pas Kr. Përbëhej pothuajse i tëri nga blloqe gurësh dhe nuk kishte spolie. Muri mbyllte një derë që të çonte drejt një ambienti si koridor midis tij dhe Ndërtesës Lindore.

Ndërtesa ishte rindërtuar gjatë periudhës Mesjetare, ndoshta në shekullin e 10-11. Ndërtesa ndoshta është ndërtuar si një zëvendësim për ndërtesën Romake Lindore, pas përfundimit të forumit, në fund të shekullit të 4-t. Edhe pasi forumi ishte mbushur në atë kohë, zona ende mbeti një shesh i hapur. Ndërtesa Romake Lindore e vjetër nga kjo pikë mund të ketë qenë përtej riparimit. Kështu që në Antikitetin e Vonë ndërtesa mund të ketë shërbyer si Ndërtesa e re Lindore e sheshit të qytetit.

Zona 21

Kuadrati në Zonën 21 kishte përmasa 14,9 m Veri-Jug x 9,5 m Lindje-Perëndim. Gërmimet sollën në dritë një ndërtesë të ruajtur mirë me shumë dhoma të një shtëpie, të ndërtuar me spolie gurësh dhe tullash (Fig. 12). Struktura përmban të paktën nëntë faza të dallueshme të ndërtimit. Faza përfundimtare e saj përfshin një bazament për shkallët, duke sugjeruar se shtëpia ishte me dy kate.

Kufiri i pronës së banesës shënohej nga një mur tarracues, i cili u gjet përgjatë anës jugore të kuadratit deri në Ndërtesën Lindore duke përfshirë edhe një pjesë të murit perëndimor të saj. Prona kishte një pus të ndërtuar me gur, i cili arrinte një thellësi të paktën 4 m nga sipërfaqja.

Dëshmitë e qeramikës e vendosin ndërtimin origjinal të banesës gjatë Antikitetit të Vonë, rreth shekullit të 6 pas Krishtit. Ndërtimi i shtëpisë ka shkaktuar një cungim në shkallë të madhe të zonës që shkatërroi pjesën më të madhe të Ndërtesës Lindore Romake dhe përcaktoi lartësinë aktuale të mureve në mes të pjesëve jugore të ndërtesës. Kjo tregohet nga lartësia e mbijetuar e Ndërtesës Lindore, që është në nivel në të gjithë këtë zonë. Faza e parë e murit tarracues ishte ndërtuar pikërisht në këtë nivel. Për më tepër, muret më të lartë të mbijetuar të Ndërtesës Lindore, me përmasa 2,7 m, ndodhen pikërisht ku muri tarracues kap dhe inkorporon Ndërtesën Lindore. Pak më në veri të kësaj pike, një pjesë e murit u shemb për të krijuar një derë që të çonte në rrugicën e formuar ndërmjet Ndërtesës Lindore Romake dhe asaj të Antikitetit të Vonë. Nuk është rastësi që niveli i derës korrespondon saktësisht me nivelin uniform të ndërhyrjes prej zonës qendrore në drejtim të anës jugore të ndërtesës. Në fakt, ky nivel korrespondon me sipërfaqen mbi të cilën janë ndërtuar tarracat dhe shtëpia.

I njëjti mur tarracues dhe shtëpi janë rindërtuar në shekullin e 10-të / 11-të pas Kr.. Kjo është një dukuri e jashtëzakonshme, sepse ajo tregon vazhdimësinë në kufijtë e pronës ndërmjet periudhës së Antikitetit të Vonë dhe Mesjetës së qytetit, që është midis shekullit të 7-të dhe shekullit të 10-të, një periudhë për të cilën ka aktualisht shumë pak dëshmi të jetës urbane në Butrint. Banesa është shkatërruar përfundimish dhe gjithë zona u rrafshua

për ndërtimin e tarracave të mëdha. Gërmimet e një muri të madh tarracues në Zonat 20 dhe 21 tregojnë se tarracat datojnë po në atë kohë rreth shekullit të 10-të / 11-të pas Kr. Ky aksion për tarracimin është i rëndësishëm sepse efektivisht u shtri në të gjithë qendrën e lashtë urbane në fundin e shtatit jugor të Akropolit, nga zona e Teatrit në zonën e Portës me Kulla. Ai përfaqëson një rizhvillim në shkallë të gjerë në gjithë qytetin e Butrintit në mënyrë të centralizuar, program i cili përfshinte shkatërrimin e ndërtesave private dhe publike në të gjithë qytetin.

Më poshtë, gërmimet arritën në dyshemene e brëndshme të ndërtesës Lindore. Dyshemeja ishte prej llaçi të trashë, të verdhë, e rezistent ndaj ujit. Siç u diskutua më sipër, kjo ka gjasa të përfaqësojë një bazament për dysheme prej mermeri apo guri, e cila do të ketë qenë grabitur kur ndërtesa u braktis. Gërmimet e ekspozuan dyshemenë në një zonë të madhe të brëndshme të ndërtesës (7,3 m Veri-Jug x 8,2 m Lindje - Perendim). Ndërtesa me sa duket ishte zhvatur tërësisht pas braktisjes së saj, pasi nuk u gjetën mbetje in-situ mbi shtresën e llaçit. Megjithatë, një bazament i madh prej guri gëlqeror me kallëp u zbulua, i cili duhet të ketë ardhur nga ndërtesa. Bazamenti ka gjasa të ketë qenë për të mbështetur një kolonë të brëndshme. Një segment i vogël i murit Lindor të ndërtesës u zbulua, duke demonstruar se Ndërtesa i Lindore në fazën e parë kishte përmasa 23,3 m V-J x 11.6 m L-P. Planimetria, forma dhe dimensionet e Ndërtesës Lindore sugjerojnë se ajo ka funksionuar si një bazilikë.

Hapësira e madhe e brëndshme e ndërtesës, me përmasa 11,6 m gjatësi, do të kishte të nevojshme përdorimin e kolonave të brëndshme për të mbështetur çatinë e drurit. Megjithatë, nuk u gjetën themele llaçi për kolonat në ndërtesë. Për shkak se sedimentet nën dyshemenë e ndërtesës ishin nën ujë dhe të lëvizshme, ka të ngjarë që kolonat e brëndshme të ndërtesës të ishin vendosur mbi bazamente prej guri gëlqeror, si ajo e zbuluar në ndërtesë, e vendosur direkt në nën-dyshemenë prej llaçi. Trashësia e shtresës së llaçit dhe sipërfaqja e madhe e bazamentit duhet të kenë siguruar rezistencë të mjaftueshme për të mbështetur kolonat. Kështu, bazilika ndoshta përmbante dy rreshta të kolonave të brëndshme, të cilat janë grabitur më vonë pasi ndërtesa u braktis kur forumi doli jashtë përdorimit në fund të shekullit të 4-t pas Kr. Kolonat prej graniti, të cilat ishin përdorur për të bllokuar portën




Fig 13 Figurinë prej terrakote që paraqet një kokë femre

jugore, me shumë mundësi mund të kenë ardhur nga kolonat origjinale të brëndshme të ndërtesës (Fig.6). Në fakt, është e mundur që kolonat e granitit të Ndërtesës Lindore të jenë përdorur përfundimisht për ndërtimin e Pagëzimores pas braktisjes së forumit dhe Ndërtesës Lindore.

Një kuadrat me përmasa 3,5 m VJ x 7,3 m LP u vendos brenda ndërtesës në mënyrë që të

gërmohej poshtë për depozitat më të hershme të qendrës së lashtë urbane. Poshtë nivelit të bazilikës, depozitat e ndërtimit të ndërtesës nuk përmbanin qeramikë të datimit në periudhën perandorake romake, duke sugjeruar se bazilika ishte ndërtuar fillimisht në fund të shekullit të 1-rë para Kr. Ose në fillim të shekullit të 1-rë pas Krishtit. Bazilika është e së njëjtës kohë me ndërtimin e forumit.

Depozitat Helenistike më poshtë ndërtesës zbuluan një figurinë në terrakotë të një kokë femre, që daton në shekullin e 3-të ose shekullin e 2-të para Kr. (Fig. 13).

Depozitat nënujore kishin ruajtur jashtëzakonisht mirë materiale organike. Përveç gjetjes së farave dhe copave të drurit natyral, u zbuluan fragmente të një parmende prej druri që daton në shekullin e 4-t para Kr. Maja e parmendës ka formë pesëkëndore dhe ishte latuar për tu përdorur si sharrë ose sëpatë (Fig. 14.). Kjo përfaqëson objektin e parë para-romak prej druri të zbuluar në Butrint. Gërmimet përfundimisht arritën një thellësi prej shtatë metrash nga sipërfaqja. Depozitat më të ulëta në qendrën urbane përmbanin sasi të konsiderueshme të qeramikës së importuar që daton në fillim të shekullit të 7-të dhe 6-të para Krishtit, duke përfshirë vazo Protokorintike dhe amfora Korintike të tipit A (Fig. 15).



Fig 14 Maja e një parmende prej druri, shek 4 para Kr. (Zona 21)

Konkluzionet

Në 2012, projekti identifikoi dhe gërmoi ndërtesën më dominante arkitekturore në sheshin e qytetit në fundin lindor të forumit. Ndërtesa duket të jetë një bazilikë romake, e ndërtuar në fund të shekullit të 1-rë para Kr. ose fillimi i shekullit të 1-rë pas Kr. Forumi në Butrint tani mund të vendoset në mesin e llojeve të forumeve me bazilikë që gjenden në të gjithë krahinat e Perandorisë Romake, të tilla si në Korint dhe forumin perandorak të Trajanit në Romë (Russel 1968; Balty 1991). Bazilika u riorientua në një pikë drejt jugut dhe një aneks është shtuar në fundin verior të ndërtesës duke zgjeruar gjatësinë e saj në 30 m. Zbulimi dhe gërmimi i bazilikës së forumit ka prodhuar një dokumentim arkeologjik për ndërtimin më të madh dhe më të rëndësishëm romak në qendrën urbane.




Fig 15. Qeramikë e importuar nga Korinti dhe Korkyra, shek. 7-të – 5-të para Kr. (Zona 21)

Duke qenë se bazilika dhe imazhi i saj publik do të kishte shërbyer për të shfaqur supremacinë e perandorit dhe familjes së tij përmes mirësisë elitare, gjermimi i Bazilikës ka kontribuar me prova të rëndësishme për zhvillimin e Butrintit nën regjimin Romak. Administrimi i provincave romake varej kryesisht në dialog midis pushtuesit (Roma) dhe të pushtuarit (Epiri), dhe në mënyrë specifike mes autoriteteve perandorake (perandori, guvernatori provincial) dhe elita lokale, të cilët luajtën një rol vendimtar në shfrytëzimin e tokës, patronazhin, dhe vendim marrjen ekonomike, duke e bërë në nivel të qytetit. Për shkak se Bazilika zinte pozicionin më të rëndësishëm në forum, ndërtesa do të ketë qenë përfituesi kryesor i bamirësisë qytetare. Karakteristikat fizike të Bazilikës - data e saj e themelimit, fazat e zhvillimit, arkitektura dhe zbulimet reflektonin ideologjitë e banorëve të qytetit. Analiza dhe publikimi i arkitekturës, objekteve dhe depozitave stratigrafike nga bazilika do të adresojnë pyetje të gjera në lidhje me dialogun themelor ndërmjet autoriteteve perandorake dhe atyre provinciale, si dhe opinionin politik të qytetit gjatë kohës. Data e ndërtimit të Bazilikës dhe fazat e saj të rindërtimit reflektojnë gjithashtu në një nivel më të madh fazat e zhvillimit të të gjithë forumit, nga themelimi e deri në fundin e tij.

Në 2012, projekti gërmoi shtatë metra nën sipërfaqen moderne - një thellësi e gjermimit që kurrë nuk ishte arritur më parë në Butrint për shkak të nivelit të ujit. Projekti ishte në gjendje të zbulonte mbetjet fizike nga fazat më të hershme të qendrës së lashtë urbane. Kolonizimi grek i bregdetit jugor të Adriatikut dhe Jonit mendohet të ketë ndodhur në shekujt 8-të apo 7-të para Kr., së bashku me kolonizimin grek të jugut të Italisë dhe Sicilisë. Dëshmi fizike për datimin e themelimit të ndonjë prej kolonive greke apo vendbanimeve

në bregdetin e Ballkanit perëndimor mungon (p.sh., Epidamni, Apollonia, Orikumi etj). Analiza e detajuar dhe botimi i materialit të gjetjeve nga nivelet më të thella në qendrën urbane të Butrintit do të sigurojë një pasqyrë të re për rolin e Butrintit në periudhën arkaike. Rezultatet kanë potencial për të krijuar një model të ri për origjinën e Butrintit dhe natyrën e kolonizimit dhe vendbanimeve greke përgjatë bregut të Deti Jon.